

VENDIM
Nr. 41, datë 5.10.2023

PËR REFUZIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR TË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME, QARKU SHKODËR, SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime” (vendimi i KKRR-së nr. 539); dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 32, datë 13.9.2023, “Për një ndryshim në vendimin e KKRR-së nr. 28, datë 23.6.2023, ‘Për shtyrje të afatit të aplikimit nga shoqëritë ujësjellës-kanalizime për tarifa të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura për vitin 2023’” (vendimi i KKRR-së nr. 32),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 5.10.2023, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit, mbi kërkesën e Ujësjetllës-Kanalizime, Qarku Shkodër, sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

KONSTATOI SE:

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime, Qarku Shkodër, ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 644 prot., datë 29.9.2023, me lëndë: “Kërkesë për nivel të ri tarife për Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës- Kanalizime, Qarku Shkodër, për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimin ujërave të ndotura”.

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime, Qarku Shkodër, është një shoqëri e re, e themeluar me datë 5.4.2023, me NIPIT: M37819701O, në zbatim të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura dhe është e pa licencuar nga ERRU-ja.

Bazuar në pikën 1, të nenit 15, të ligjit nr. 8102, ku parashikohet, se: “Personat fizikë apo juridikë, që merren me veprimtarinë e grumbullimit, të shpërndarjes, largimit dhe trajtimit të ujit, për përfitim publik, duhet të pajisen me licencë nga ERRU-ja”, dhe në pikën 2, të nenit 22, të ligjit nr. 8102, ku citohet, se: “Procedura për vendosjen e tarifave fillon me propozimin e bërë nga i licencuari, dhënie e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore dhe përfundon me miratimin përfundimtar të tarifave nga Enti Rregullator”, si dhe referuar pikës 1, të nenit 8, të vendimit të KKRR-së nr. 539, ku parashikohet, se: “Vetëm operatorët e licencuar kanë të drejtë të aplikojnë për tarifa shërbimi ujësjellës-kanalizimesh pranë ERRU-së”, është kusht i domosdoshëm pajisja e shoqërisë me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura nga ERRU-ja përpara aplikimit për nivel të ri tarifor.

Për gjithë sa me sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të refuzojë aplikimin për ndryshimin e tarifave të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime, Qarku Shkodër.

2. Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime, Qarku Shkodër, duhet të aplikojë për licencim pranë Entit Rregullator të Ujit.

3. Drejtoria Tekniko-Ekonomike ngarkohet të njoftojë Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime, Qarku Shkodër, për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani